



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 21.20.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË ADMINISTRATËS
TATIMORE TË KOSOVËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31
DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Administratës Tatimore të Kosovës, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Blerim Kabashi (Udhëheqës Ekipi), Lindita Ajeti dhe Fanol Hodolli (Anëtarë Ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Emine Fazliu.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	14
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	28
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	29
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	32
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	34

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetore të Administratës Tatimore të Kosovës për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit për Institucionet Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 14.11.2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Administratës Tatimore të Kosovës.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat financiare vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Për më gjerësisht shih pjesën 1.1 të këtij raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Falënderojmë Drejtorin e Përgjithshëm dhe stafin e tij mbështetës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimit të Auditimit”

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e Drejtorit të Përgjithshëm

Drejtori i Përgjithshëm ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinion i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa "Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare". Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të ATK-ës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga ATK kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Çështjet e ngritura në Memorandumin e Auditimit, të datës 23.12.2016, në lidhje me kornizën raportuese janë zbatuar nga menaxhmenti.

Në PFV ishin të nevojshme disa korrigjime financiare për të cilat kemi dhënë sugjerime për të përmirësuar cilësinë e tyre. Pas sugjerimeve tona, ATK ka korrigjuar PFV-të para finalizimit të tyre.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave mund të konsiderohet e drejtë dhe e vërtetë.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për ATK-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe të forcoj sistemin e kontrollit.

Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit që plotësohet nga ATK duhet të sigurojë një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuara përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin tre të këtij raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Qeverisja në ATK lidhur me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial pasqyron një situatë pozitive. Kjo gjendje ka reflektuar sepse ATK ka plotësuar pyetësin e vet-vlerësimit, ka hartuar planin e detajuar të trajtimit të rreziqeve si dhe kishte bërë monitorimin e tyre në baza mujore.

Sa i përket raportimit të brendshëm, zëvendës drejtorët e përgjithshëm dhe drejtoret e departamenteve mbajnë takime të rregullta javore dhe mujore me Drejtorin e Përgjithshëm, duke raportuar dhe diskutuar për të gjitha aktivitetet e tyre. Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) kishte finalizuar dhjetë (10) raporte të auditimit, të cilat menaxhmentit i ofruan një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe efektivitetin e tyre.

Megjithatë ende vërehen mangësi në qeverisje brenda ATK-së veçanërisht në lidhje me zbatimin e rekomandimeve si dhe mos funksionalizimin e plotë skemës së re organizative.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti jonë i auditimit për PFV-të e vitit 2015, ka rezultuar me 12 rekomandime. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, gjashtë (6) rekomandime ishin zbatuar plotësisht, dy (2) janë në proces dhe katër (4) prej tyre nuk janë zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 1 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

- E gjetura** ATK ka hartuar me kohë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e vitit 2015, si dhe ka zbatuar një pjesë të rekomandimeve. Mirëpo, edhe me tutje, moszbatimi i plotë i të gjitha ka ndikuar që mangësitë e njëjta të përsëriten nga viti i kaluar. Rekomandimet e pazbatuara kanë të bëjnë me mos përpilimin e një plani për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve, mos harmonizimi i të hyrave me Thesarin sipas kërkesave ligjore, rritja e llogarive të arkëtueshme ndër vite, pagesa me vendime të gjykatave si dhe mos menaxhimi i pasurive jo kapitale përmes sistemit e-pasuria.
- Rreziku** Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë në mos efikasitet të vazhdueshëm të kontrolleve, vështirësi në menaxhimin e sfidave në përmbushjen e objektivave apo edhe në humbje financiare.
- Rekomandimi 1** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që plani i veprimit, rishikohet, duke analizuar shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor, si dhe stafin llogaridhënës për zbatimin e tyre. Në fokus fillestar duhet të jenë fushat e një rëndësie më të madhe. Zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet në vazhdimësi.

2.2 Pyetësoni i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetëson të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësorit.

Ne kemi përmbledhur konkluzionet tona për ATK-në të cilat së bashku me të gjeturat dhe konkluzionet e nxjerra në auditimet tjera do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të jap koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do ta jap gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për t'i mbështetur përpjekjet e MF në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar pyetjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponentët e tij. Për pyetjet e shqyrtuara kemi vlerësuar se:

- Menaxheret e sektorëve dhe drejtorive ishin pjesë e diskutimeve për planin strategjik 2015-2020. Për të mbështetur zbatimin e kësaj strategjie ishte hartuar edhe plani i punës si pjesë integrale e planit strategjik, ku përcaktohen aktivitetet konkrete, njësitë përgjegjëse organizative dhe afatet e plotësimit;
- Në mënyrë që të ndërmerren masat e nevojshme për shmangien eventuale apo menaxhimin efektiv të rreziqeve të identifikuara, ATK-ja kishte hartuar planin e detajuar për trajtimin e rreziqeve ku ishin marrë parasysh burime të jashtme dhe ato të brendshme. Me tutje ky plan ishte monitoruar në baza mujore, tremujore dhe vjetore nga departamenti për menaxhim të rrezikut;
- Plani i prokurimit ishte përgatitur në përputhje me disponueshmërinë e fondeve buxhetore të miratuara, dhe se i njëjti është dërguar në Agjencinë Qendrore të Prokurimit;
- Informimi si dhe raportimi i të hyrave dhe shpenzimeve kryhej në baza mujore, javore dhe sipas kërkesave të menaxhmentit për vendimmarrje raportohej edhe në baza ditore; dhe
- Monitorimi i arritjes së objektivave kryhej në baza të rregullta tremujore. Këto raporte ishin narrative dhe paraqitnin gjithë procesin e monitorimit në realizimin e objektivave të organizatës për vitin 2016.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

2.3 Rishikimet specifike të qeveriseje

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit ATK operon dhe sfidat me të cilat përballlet.

2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

ATK kishte përgatitur planin strategjik 2015-2020. Qëllimet dhe objektivat strategjike të ATK-së janë në përputhshmëri të plotë me strategjinë dhe politikat zhvillimore të MF-së dhe Qeverisë së Kosovës, për rritjen e përgjithshme të aftësive/shkathtësive të stafit, përmirësimin e proceseve kyçe tatimore të ATK-së, zvogëlimin e nivelit të ekonomisë joformale, ripërtëritjen e teknologjisë informative për të mundësuar punë më efikase brenda ATK-së dhe shërbime të përmirësuara për tatimpaguesit si dhe sigurimin e një strukture organizative efektive mbështetur nga mekanizma të fortë qeverisës dhe llogaridhënie të qartë.

Përkundër kësaj ATK nuk kishte arritur që plotësisht të funksionalizoj strukturën organizative në mungesë të plotësimin të të gjitha pozitave me kandidatë përkatës.

Çështja 2 - Mos funksionalizimi i plotë i strukturës së re organizative 2016 - Prioritet i lartë

E gjetura	Pas aprovimit të rregullores së re për sistematizimin e vendeve të punës në ATK (30.06.2016), edhe më tutje njëmbëdhjetë (11) pozita nga departamente dhe divizione të ndryshme nuk ishin funksionale. Kjo kishte ndodhur si rezultat i vonesave nga MAP-DASHC, lidhur me aprovimin e kërkesave të ATK-së për hapjen e konkurseve, si dhe paqartësive për emërtimin e pozitave dhe gradave.
Rreziku	Vonesat në plotësimin e pozitave menaxheriale me kandidatë përkatës, rrisin rrezikun që struktura e re organizative të mos jetë mjaftueshëm funksionale dhe efektive. Po ashtu rrezikon edhe arritjen e objektivave të përcaktuara.
Rekomandimi 2	Drejtori i Përgjithshëm duhet siguroj se janë ndërmarr veprime të nevojshme për të eliminuar barrierat me MAP-in si dhe të fillohet me procedura të rekrutimit që mundësojnë plotësimin e pozitave me zyrtar të rregulltë brenda një afati të arsyeshëm kohor, në menyrë që të arrihet funksionalizimi i plotë i strukture organizative në ATK.

2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

ATK është agjenci në kuadër të MF-it, PFV-të e saj konsolidohen në kuadër të PFV-ve të MF-së. Për të siguruar një menaxhim financiar efektiv nevojitet një proces efektiv i konsolidimit dhe raportimit me kohë. ATK-ja ka strukturën e saj organizative, menaxhuese dhe llogaridhënëse dhe se Drejtori i Përgjithshëm raporton te Ministri i Financave në periudha të rregullta mujore.

Departamentet në kuadër të ATK-së kanë plane veprimi për zbatimin e objektivave të parapara me aktivitetet e tyre operative, dhe njëherit në baza mujore dhe tremujore kryejnë monitorimin apo matjen e arritjes së objektivave të përcaktuara me plan strategjik.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

NjAB është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm. Ne marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit (KA). Përveç kësaj, ne i shqyrtojmë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë si rezultat i punës së kryer nga NjAB dhe KA.

NjAB për vitin 2016 kishte përgatitur planin vjetor sipas të cilit kishte planifikuar dhe realizuar dhjetë (10) auditime.

Përmes raporteve të auditimit, menaxhmentit i janë ofruar informata të rëndësishme për sistemet e kontroleve në departamente të caktuara. Drejtoritë/departamentet që auditohen nga NjAB obligohen të raportojnë në periudha tremujore lidhur me nivelin e zbatimit të rekomandimeve.

NjAB për punën e saj raporton edhe në Njesinë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm (NjQHAB) përmes raporteve tremujore. Linja tjetër e raportimit është te KA, i cili funksionon në kuadër të MF-së. ATK-ja raporton në KA me anë të një përfaqësuesi. KA, gjatë vitit 2016 kishte mbajtur katër (4) takime, në të cilat ishin diskutuar rekomandimet e NjAB-së, dhe rekomandimet e raportit të auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2015.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy (2), pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, burimeve njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

ATK në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

ATK në përgjithësi ka një sistem të dizajnuar mirë dhe funksional në menaxhimin e të hyrave. Në krahasim me vitin e kaluar ATK gjatë vitit 2016 ka shënuar rritje në realizimin e të hyrave bruto për 53,613,187 apo 16%. Po ashtu edhe realizimi i buxhetit final prej 99%, paraqet një performancë të mirë buxhetore.

Megjithatë, auditimi ynë ka identifikuar disa dobësi në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin në fuqi. Kjo përfshinë kryesisht procesin e mos barazimit të të hyrave mes kontabilitetit të ATK-së më Thesarin, raportit të BQK-së me kontabilitetit e ATK-së, menaxhimi i kthimeve jo në pajtueshmëri me kërkesat ligjore, menaxhimi i burimeve njerëzore, menaxhimi i llogarive të arkëtueshme dhe funksionimi i sistemit e-pasuria.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	9,591,571	8,930,523	8,858,124	8,079,103	8,081,656
Granti i Qeverisë -Buxheti	9,591,571	8,930,523	8,858,124	8,079,103	8,081,656

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 661,048€. Ky zvogëlim është rezultat i rishikimit buxhetor dhe vendimeve të Qeverisë. Në vitin 2016, ATK-ja ka realizuar 99% të buxhetit final ose 8,858,124€.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	9,591,571	8,930,523	8,858,124	8,079,103	8,081,656
Pagat dhe Mëditjet	6,959,402	6,889,254	6,889,254	6,585,102	6,151,283
Mallrat dhe Shërbimet	888,597	1,473,597	1,423,735	1,196,993	1,253,266
Shërbimet komunale	168,572	206,876	184,339	202,898	202,361
Investimet Kapitale	1,575,000	360,796	360,796	94,110	474,746

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Me rishikim të buxhetit kategoria e pagave dhe mëditjeve ishte zvogëluar për 70,148€, me këtë zvogëlim realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 100%;
- Buxheti final në raport me buxhetin fillestar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ishte rritur për 585,000€. Kjo rritje kishte rezultuar nga vendimet e Qeverisë ku ishin transferuar mjete në vlerë prej 485,000€ si dhe nga transferimi i mjeteve prej 100,000€ nga programi i Doganës në programin e ATK-së;
- Me rishikim të buxhetit, kategoria e shërbimeve komunale ishin rritur për 38,304€ përderisa realizimi ishte në masën prej 89%; dhe
- Me rishikim të buxhetit kategoria e investimeve kapitale ishte zvogëluar për 1,214,204€. Shkurtimi i buxhetit ishte bërë për projektet e planifikuara për realizim në gjysmen e dytë të vitit 2016.

Tabela 3. Te hyrat e inkasuara për buxhetin e Kosovës - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Te hyrat bruto	380,000,000	385,000,000	386,385,187	332,772,000	303,695,000
Kthimet	(35,500,000)	(34,100,000)	(31,005,000)	(28,769,000)	(31,108,000)
Te Hyrat neto	344,500,000	350,900,000	355,380,187	304,003,000	272,587,000

ATK në vitin 2016, ka realizuar të hyra buto 386,385,187€, që në raport me vitin 2015 kishte rritje për 53,613,187€ (16%). Rritja më e madhe është arritur tek tatimi në korporata prej 13,385,211€ (20%), TVSh-ja me 25,209,755€ (16%), tatimi në paga 8,237,957€ (11,4%), tatimi nga bizneset individuale me 2,402,732€ (7,8%) dhe në burime tjera prej 4,377,532€.

Performanca e mirë në realizimin e të hyrave në vitin 2016, ishte rezultat i ndërmarrjes së veprimeve të duhura nga menaxhmenti i ATK-së, në forcimin e sistemit të kontrolleve, që kanë rezultuar me uljen e in-formalitetit si dhe zvogëlimin e shmangieve tatimore.

Çështja 3 – Keq-klasifikimi i buxhetit – Prioriteti i lartë

E gjetura Sipas Rregullës Financiare 01/2013 - Shpenzimi i parave publike, neni 18 - Inicimi i Shpenzimeve, të gjitha blerjet duhet të plotësohen dhe regjistrohen saktë në kategori ekonomike. Ne identifikuam disa raste të keq-klasifikimeve si:

- ATK kishte kryer dy (2) pagesa në vlerë totale prej 35,094€ për përkrahjen (mirëmbajtje) e sistemit informativ bazë të tatimeve SIGTAS, si dhe një (1) pagese në vlerë prej 3,858€ për pajisje tjera. Të tri (3) pagesat ishin kryer nga kategoria e investimeve kapitale, përderisa rregullat e thesarit i kategorizojnë si mallra dhe shërbime; dhe
- Në mungesë të mjeteve në kategorinë mallra dhe shërbime, ATK kishte kryer retroaktivisht pagesën për 60-të të angazhuarit për shërbime të veçanta, në vlerë prej 73,353€ nga kategoria e pagave dhe mëditjeve.

Rreziku Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në një keqkuptim të aktiviteteve financiare të ATK-së. Mos raportimi i drejtë zvogëlon efektivitetin e kontrolleve menaxheriale, si dhe ndikon në mbivlerësimin e njëres kategori dhe nënvlerësimi të kategorisë tjetër.

Rekomandimi 3 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë forcuar linjat raportuese, në mënyrë që planifikimi dhe buxhetimi i projekteve të caktuara bëhet bazuar në planin kontabël të aprovuar nga Thesari.

3.1.1 Të hyrat

ATK në përgjithësi ka një sistem funksional në menaxhimin e të hyrave. Të hyrat e planifikuara nga Qeveria e Kosovës për vitin 2016 ishin 385,000,000€, përderisa të hyrat bruto të realizuara ishin 386,385,187€, me tejkalim të planit vjetor për 1,385,187€, ose 0.4%.

Tabela 4. Te hyrat e inkasuar për buxhetin e Kosovës - sipas kodeve ekonomike (në €)

Përshkrimi	Kodet ekonomike	2016	2015
Tatimi i Paragjykuar	40010	21,000	6,000
Tatimi në Fitim	40020	1,000	1,000
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	40030	179,203,000	153,962,000
TVSh-ja e shtyre	40035	90,000	818,000
Tatim ne paga -mbajtur në burim	40040	79,850,000	71,716,000
Tatimi për biznese individuale	40050	32,125,000	29,059,000
Tatimi mbi qiranë dhe pasurinë e patrupëzuar	40060	819,000	1,540,000
Tatimi i mbajtur ne burim ne interes,	40065	11,187,000	6,362,000
Tatimi për korporata	40070	80,797,000	67,653,000
Extra profit	40080	0,00	0,00
Konto kaluese	40090	7,000	8,000
Te hyrat nga gjobat e ATK-së	40095	2,187,000	1,579,000
Komp. e dëmeve	50109	1,000	5,000
Licenca për lojëra	50210	96,000	60,000
Te hyra-shitja e mbeturinave	50416	1,000	0,00
Te hyrat - shitja e mall.	50421	0,00	3,000
Totali		386,385,000	332,772,000

Çështja 4 - Mos harmonizim i të hyrave të ATK-së me Thesarin - Prioriteti i lartë

E gjetura Sipas nenit 13 të rreg. financiare nr. 03/2010, ATK është e obliguar që të bëjë barazimin e të hyrave me Thesarin në baza mujore.

Zyrtarja e të hyrave nuk kishte bërë barazime të rregullta mujore, mirëpo barazimet me Thesarin ishin bërë në periudha tremujore dhe se në asnjë nga këto raporte të barazimeve nuk ishin dhënë shënime sqaruese sa i përket mosbarazimit ndërmjet kontabilitetit të ATK-së dhe të dhënave nga Thesari.

Sipas Thesarit, në fund vitit 2016 të hyrat ishin 386,385,187€, ndërsa sipas kontabilitetit të ATK-së të hyrat ishin 378,881,474€, me diferencë 7,503,713€. Kjo diferencë rezulton nga vonesat e shkaktuara me rastin e procedimit të pagesave në kontabilitetin e ATK-së.

Mos barazime të të hyrave kishte edhe ndërmjet raportit Bankës Qendrore (BQK) dhe Thesarit. Shuma e mos barazimit është 188,737€, për këtë vlerë të hyrat në Thesar ishin të nënvlerësuara. Zyrtarja përgjegjëse për barazime nuk ka ofruar sqarime për këtë mos barazimin.

Rreziku Mos shpalosja e mosbarazimeve mes kontabilitetit të ATK-së në raport me burimet tjera të të dhënave (Thesarin dhe BQK-në) e vë në dyshim edhe besueshmërinë dhe saktësinë e informatave për të dhënat e raportuara të ATK-së në përgjithësi.

Rekomandimi 4 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se procesi i harmonizimit të të hyrave zhvillohet në pajtueshmeri me kerkesat ligjore, si dhe të siguroj se ofrohen shënime sqaruese me rastin e mos harmonizimit të shënimeve të kontabilitetit të ATK-së me raportet e Thesarit. Kjo duhet të bëhet me qëllim që t'i mundësoj menaxhmentit të ATK-së të merr vendime bazuar në informatat e sakta dhe të plota.

Çështja 5 - Mos harmonizimi i të dhënave për kthimet ndërmjet ATK-së dhe Thesarit - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Vlera e mos harmonizimit të kthimeve ndërmjet të dhënave të ATK-së dhe shënimeve të Thesarit në vitin 2015 ishte 974,814€. Në vitin 2016 vlera e mos harmonizimit ishte shumë më e ulët, në vetëm 62,011€ që paraqet progres në raport me vitin paraprak. Sipas zyrtareve të ATK-së edhe përkundër përpjekjeve për të harmonizuar plotësisht të dhënat, Departamenti Thesarit nuk ka bërë korrigjimin me kohe të ndryshimeve të ndodhura sa i përket kthimeve.
- Rreziku** Ndryshimet në informata mes Thesarit dhe ATK-së vënë në dyshim besueshmërinë e të dhënave të raportuara.
- Rekomandimi 5** Drejtori i Përgjithshëm në koordinim me Departamentin e Thesarit duhet të sigurojë kontrolle shtesë për të siguruar harmonizim të plotë të të dhënave lidhur me kthimet.

Çështja 6 - Vonesa në shqyrtimin e kthimeve (rimbursimeve) - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat, neni 30, obligon ATK-në që të aprovoj një kërkesë të vlefshme për kthim (rimbursim) brenda 60 ditëve nga data e pranimit të kërkesës në ATK. Nëse kërkesa nuk është shqyrtuar brenda këtij afatit, atëherë në këto raste ATK përveç kthimeve duhet të paguaj edhe interesin tatimpaguesve.
- Përkundër progresit të treguar në raport me vitin 2015, ne identifikua se në tetë (8) raste, kërkesat për kthim nuk ishin shqyrtuar brenda afatit ligjor. Tejkalimi i këtij afati ligjor në një rast ishte deri në 44 ditë. ATK nuk i kishte paguar interesin tatimpaguesve për vonesat e ndodhura.
- Rreziku** Vonesat në rimbursime mund të dëmtojnë buxhetin e ATK-së si pasojë e pagesave të interesit nga ana e ATK-së.
- Rekomandimi 6** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarr veprime shtesë që kërkesat për kthime (rimbursime) të shqyrtohen brenda afatit të përcaktuar kohor dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.

Çështja 7 – Mos fiskalizimi i bizneseve që operojnë me derivate - Prioritet i lartë

- E gjetura** ATK-ja për vitin 2016, në planin e punës kishte caktuar si një ndër objektivat kryesore fiskalizimin e bizneseve që merren me tregtimin e derivateve.
- Sipas shënimeve të ATK-së, nr.i bizneseve në Kosovë që zhvillojnë tregti me derivate është 333, me gjithsej 539 pika të shitjes. Prej këtij numri me arka fiskale janë të pajisura 258 pika të shitjes, ose 48% e tyre, ndërsa 281 pika të shitjes, ose 52% edhe më tutje operojnë pa arka fiskale.
- Sipas ATK-së vështirësitë me të cilat janë ballafaquar në përmbushjen e kësaj objektive ishte refuzimi i bizneseve për tu pajisur me arkën fiskale për shkak të çmimit të lartë. Megjithatë, në vitin 2016 ishte licencuar edhe një operator për shitjen e Paisjeve Elektronike Fiskale (PEF), dhe se kjo kishte ndikuar në uljen e çmimit dhe në rritjen e interesimit të bizneseve për të pajisur me PEF.
- Rreziku** Vonesat e shkaktuara në procesin e fiskalizimit të bizneseve për pasojë mund të kenë shmangien e mundshme tatimore, dhe kjo rezulton me një konkurrencë jo të barabartë ndërmjet bizneseve që tregtojnë me karburante të naftës.
- Rekomandimi 7** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë shtuar kontrollet si dhe janë ndërmarrë masat e nevojshme, për të obliguar të gjitha bizneset që merren me tregtimin e derivateve pajisen me arka fiskale.

Çështja 8 - Mos kontrollimi i bizneseve të çregjistruara - Prioritet i lartë

- E gjetura** Sipas neni 11 të ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe sipas neneve 9 dhe 12 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010 “*Kur një biznes propozon ndryshimin e formës së vet të pronësisë, biznesi i ri duhet të aplikojë për një numër të ri fiskal sipas procedurave të përshkruara - Biznesi i vjetër duhet të kërkojë çregjistrimin në përputhje me procedurat e përshkruara*”.
- Ne identifikuar se tri (3) biznese të cilat pas çregjistrimit në ndryshimin e formës dhe pronësisë së bizneseve kanë zhvilluar aktivitete biznesore, në kuadër të biznesit të çregjistruar, duke lëshuar fatura dhe realizuar të hyra nga Buxheti i Kosovës në vlerë prej 13,600€. Këto biznese nuk ishin kontrolluar nga ATK-ja dhe nuk kishin deklaruar të ardhura të realizuara.
- Rreziku** Mos identifikimi dhe kontrollimi i bizneseve të çregjistruara të cilat vazhdojnë të realizojnë të hyrat nga këto biznese, rrit rrezikun që këto të hyra të mos deklarohen në ATK, dhe potencialisht të ketë shmangie tatimore.
- Rekomandimi 8** Drejtori i Përgjithshëm duhet ndërmarrë të gjitha veprimet për siguruar së bizneset e çregjistruara nuk zhvillojnë aktivitete afariste dhe nuk realizojnë të hyra në emër të biznesit të çregjistruar.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat kyçe në këtë proces kanë dëshmuar plotësinë dhe saktësinë e të dhënave të prezantuara në PFV-të e ATK-së. Në këtë kategori ishin shpenzuar 100% të buxhetit final.

Ne kemi identifikuar disa çështje si: mbulimin i pozitave me ushtrues detyre (U.D) për periudhë më të gjatë se kërkesat ligjore si dhe tejkalimi i afateve të marrëveshjeve të veçanta.

Çështja 9 – Numri i lartë i mbulimit të pozitave menaxhuese me ushtrues detyre - Prioritet i lartë

E gjetura	<p>Ligji i SHC-03/L-149, neni 30 përcakton se një pozitë nuk mund të mbahet nga Ushtruesi i Detyrës (UD) për më shumë se tre muaj.</p> <p>Gjatë vitit 2016, mbaheshin 25 pozita menaxhuese me UD, prej tyre, për 21 pozita ishte tejkeluar afati ligjor. Në fazën finale të auditimit vlerësuam se në muajin mars të vitit 2017 ishin zhvilluar procedurat e rekrutimit dhe janë përzgjedhur kandidatët për 11 pozita.</p>
Rreziku	Mbulimi i pozitave të rëndësishme me UD për një kohë të gjatë, rrit rrezikun që performanca e realizuar dhe përgjegjësia në këto pozita të mos jetë në nivelin e duhur.
Rekomandimi 9	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore ku për pozitën e mbuluar me U.D bëhet një zgjidhje e qëndrueshme dhe në pajtim me kërkesat ligjore.

Çështja 10 - Marrëveshjet për shërbime të veçanta - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Neni 12 i Ligjit për Shërbimin Civil 03/L-149, përcakton se afati i marrëveshjeve për shërbime të veçanta duhet të jetë më i shkurtër se gjashtë (6) muaj.
- ATK për zbatimin e Ligjit për Faljen e Borxheve nr.05/L-043, kishte lidhur 50 marrëveshje për shërbime të veçanta. Këto marrëveshje ishin lidhur për periudhën gjashtë (6) mujore, mirëpo më pas ky afat ishte vazhduar edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë si rezultat i shtyrjes së afatit për faljen e borxheve. Në ndërkohë me 01.06.2016, ishin lidhur edhe dhjetë (10) kontrata të tjera për periudhën gjashtë (6) mujore.
- Më shtyrjen e afatit të faljes së borxheve deri me 01.09.2017 të gjithë të angazhuarve në këtë projekt ju është vazhduar marrëveshja deri në fund të muajit korrik 2017.
- Rreziku** Menaxhimi i projekteve apo aktiviteteve të caktuara përmes proceseve dhe procedurave jo adekuate, do të mund të vendos ATK-në në vështirësi buxhetore dhe do të pamundësoj përmbushjen e projekteve të përcaktuara.
- Rekomandimi 10** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë respektimin e afateve ligjore lidhur me angazhimin e stafit për kontrata-shërbime të veçanta.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime, përfshirë edhe buxhetin për shërbime komunale në vitin 2016 ishte 1,680,473€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,608,074€, ose 96%. Shpenzimet për mallra dhe shërbime kanë të bëjnë kryesisht me furnizim për zyre, karburante, mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve, shpenzime të telefonisë mobile si dhe pagesa për vendime të gjykatave.

Në këtë kategori testuam pesë (5) aktivitete të prokurimit me vlerë totale 178,052€, si dhe gjashtë (6) pagesa në vlerë totale 176,381€.

Çështja 11 - Vendimet e Gjykatës - Prioritet i mesëm

E gjetura Si pasojë e një padie nga një subjekt juridik ndaj ATK-se në emër të qirasë, në vitin 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë, kishte marrë vendim ku e obligon ATK-në të kryej obligimin në vlerën prej 47,821€. ATK nuk kishte respektuar këtë vendim duke mos kryer obligimin ndaj palës ankuese dhe se kjo çështje kishte kaluar në Gjykatën e Apelit të Kosovës.

Me pas, me datë 13.05.2016, është marrë vendim nga Gjykata e Apelit të Kosovës, ku detyron ATK-në që në afat brenda 15 ditësh të kryej këtë obligim. Në mungesë të mjeteve buxhetore ATK kishte kryer këtë pagesë me datë 15.11.2016, me vonese afro pesë (5) muaj e gjysmë.

Rreziku Mos përmbushja e detyrimeve ligjore në kohë, rritë detyrimet e entitetit dhe dëmton performancën e saj në respektimin e ligjit.

Rekomandimi 11 Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj që respektohen kërkesat ligjore në lidhje me detyrimet që rrjedhin nga Aktgjykimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës.

3.1.4 Investimet kapitale

ATK ka përgatitur planin paraprak dhe atë final të prokurimit, dhe të njëjtat janë dorëzuar me kohë në Agjencinë Qendror të Prokurimit.

Buxheti final për investime kapitale ishte 360,796€, i cili ishte realizuar në tërësi. Në kuadër të këtyre shpenzimeve ne kemi testuar pesë (5) pagesa në vlerë 333,594€ si dhe pesë (5) procedura të prokurimit në vlerë të kontraktuar prej 286,134€. ATK ka vendosur kontrolle funksionale në menaxhimin e buxhetit për këtë kategori.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Udhëzuesi kryesor në këtë fushë është rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore.

Vlera e pasurive jo financiare kapitale me vlerë mbi 1,000€ e paraqitur në PFV ishte 1,881,000€, ndërsa vlera e pasurive jo kapitale nën 1,000€ ishte 132,000€.

Çështja 12 - Mos përdorimi i sistemit e-pasuria - Prioritet i mesëm

E gjetura Përkundër rekomandimit të dhënë në raportin e vitit paraprak, për të përmirësuar menaxhimin e pasurive nën 1,000€, duke i evidentuar në softuerin e-pasuria, edhe me tutje gjendja ishte e njëjte. Pasuritë jo kapitale dhe stoqet nuk ishte menaxhuar përmes softuerit e-pasuria, mirëpo ato janë evidentuar dhe raportuar përmes një sistemi të brendshëm të tyre.

Menaxhmenti i ATK-së në vitin 2016 kishte kërkuar nga kompania përgjegjëse për implementimin e sistemit e-pasuria mirëpo kjo nuk ishte përgjigjur kërkesës së ATK-së.

Rreziku Mos menaxhimi i pasurive jo kapitale nën 1,000€ përmes sistemit e-pasuria si dhe regjistrimi i pasurive në data baza të ndryshme vështirësojnë menaxhimin efektiv të tyre, e cila mund të ndikoj në mos raportimin të plotë dhe të saktë të tyre.

Rekomandimi 12 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që janë ndërmarr të gjitha masat e nevojshme që pasurit jo kapitale regjistrohen dhe menaxhohen përmes sistemit e-pasuria.

3.2.2 Llogaritë e arkëtueshme (borxhet)

ATK ka vendosur një sistem të kontrollit të brendshëm që mbikëqyrë procesin e llogarive të arkëtueshme duke e menaxhuar përmes drejtorive përkatëse në kuadër të shtyllave funksionale të ATK-së. Megjithatë edhe më tutje sistemi i kontrollit duhet të forcohet edhe me tutje për të parandaluar rritjen e të arkëtueshme nga viti në vit dhe vlera e tyre të ulet në një shkallë të pranueshme.

Llogaritë e arkëtueshme në fund të vitit 2016 ishin në vlerë prej 321,661,828€, në këtë shumë janë të përfshira edhe kontributet pensionale në vlerë prej 58,563,681€³.

Tabela 4. Krahasimi i borxheve ndërmjet viteve 2016/15 - sipas Regjioneve (në €)⁴

Përshkrimi	Viti 2016	Viti 2015	Ndryshimi 2015/16	% Rritjes 2015/16
Drejtori Tatimi paguesve të mëdha	27,582,264	21,491,536	6,090,728	28.34
Ferizaj	27,968,510	25,903,991	2,064,519	7.97
Gjakovë	12,834,214	11,967,983	866,231	7.24
Gjilan	27,059,473	25,605,937	1,453,536	5.68
Mitrovicë	15,969,855	14,788,882	1,180,973	7.99
Pejë	21,314,091	19,921,339	1,392,752	6.99
Prishtina I	84,622,431	64,348,358	20,274,073	31.51
Prishtina II	23,961,389	21,759,647	2,201,742	10.12
Prishtina III	34,704,728	31,606,462	3,098,256	9.80
Prizreni	45,644,883	42,959,822	2,685,061	6.25
Totali	321,661,838	280,353,957	41,307,881	14.73

Llogaritë e arkëtueshme në vitin 2016 në raport me vitin 2015 ishin rritur për 41,307,871€ (14.73%). Rritja më e madhe ishte të Regjioni Prishtina-I për 31.51% si dhe Drejtoria e tatimpaguesve të mëdhenjë për 28.34%.

Në totalin e llogarive të arkëtueshme TVSH-ja merr pjesë me 144,720,945€ (45%), kontributet pensionale me 58,563,681 € (18%), tatimi në të ardhurat personale (PD) me 29,182,110€ (9%), tatimi në të ardhura korporatave (CD) në vlerë prej 25,016,075€ (8%).

³ Të arkëtueshmet për pensione, janë të arkëtueshme të Trustit Pensional të Kosovës, mirëpo pasi që ato menaxhohet nga ATK-ja, janë raportuar edhe në PFV-të e tyre.

⁴ Për çështje të krahasimi të llogarive të arkëtueshme nga baza janë larguar borxhet e falura gjatë viteve 2015 dhe 2016 në vlerë totale prej 216,124,086€.

Me hyrjen në fuqi të Ligji nr. 05/L-043 për faljen e borxheve në shtator të vitit 2015, në përputhje me ligjin për faljen e borxheve, ATK ka nxjerrë listën për faljen e borxheve. Qe nga hyrja e Ligjit në fuqi deri në fund të vitit 2016 janë falur borxhe në total prej 216,124,086€ (vlera 27,747,936€ ishin borxhet e falura gjatë vitit 2015, ndërsa pjesa tjetër prej 188,376,150€, ishin falur gjatë vitit 2016). Si rezultat i zbatimit të këtij ligji, nga fillimi i implementimit të tij janë mbledhur të hyra tatimore në shumën prej 24,200,000€, prej tyre, vetëm në vitin 2016 ishin 16,900,000€.

Çështja 13 – Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme - Prioritet i lartë

E gjetura Në planit e punës së ATK-se për vitin 2016, nga departamenti për mbledhje të detyrueshme ishin planifikuar të mblidhen borxhe në vlerë prej 89,946,809€, mirëpo ky plan nuk ishte realizuar. Deri në fund të vitit ishin mbledhur 68,306,631€ apo 76% e planit.

Trajtimi i të arkëtueshmeve, rritja e tyre nga viti në vit vazhdon të mbetet sfida për ATK-në. Mungesa e një analize për të identifikuar/nxjerrur shkaktarët e mos përmbushjes së planit të mbledhjes së borxheve ka rezultuar me një inkasim të dobët të tyre.

Rreziku Mungesa e veprimeve të mjaftueshme apo mangesitë në procesin për inkasim të arkëtueshmeve mund të mos i inkurajon subjektet tjera që t'i paguajnë obligimet e tyre me kohë. Vjetërsia e të arkëtueshmeve e vështirëson mbledhjen e tyre.

Rekomandimi 13 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se ka forcuar kontrollet në menaxhimin e të arkëtueshmeve, rritjen e efikasitetit si dhe forcimin e kontrolleve në menaxhimin dhe arkëtimin e tyre. Në këtë aspekt, të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve në mënyrë që të ndërmerren veprimet ligjore për mbledhjen e tyre.

3.2.3 Obligimet

Pasqyra e obligimeve në fund të vitit 2016 ishte në vlerë prej 46,365€. Ne testuam procesin e raportimit të obligimeve në MF, si dhe testuam pesë (5) fatura, për të verifikuar nëse raportimi është bërë në pajtueshmëri të plotë me kornizën ligjore për menaxhimin e obligimeve. Testet tona shpalosën mangësitë si në vijim.

Çështja 14 – Vonesë në pagesë si dhe raportim i mangët i obligimeve – Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas LMFPP neni 29, çdo faturë duhet të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Për me tepër ATK nuk kishte raportuar rregullisht në MF lidhur me obligimet e papaguara, përkatësisht për muajt tetor dhe nëntor të vitit 2016. Derisa ne identifikuam se brenda periudhave të njëjta kohore kishte fatura të pranuar dhe të papaguara, si:

- Fatura me nr. FDT16-8-003322 në vlerë prej 12,008€ ishte pranuar me datë 15.09.2016 dhe nuk ishte paguar deri me 18.11.2016; dhe
- Fatura me nr.23/2016 në vlerë prej 7,122€ e pranuar me datë 10.11.2016, nuk ishte paguar deri me datë 27.01.2017.

Rreziku Mos raportimi i drejtë i të gjitha obligimeve nëpër raporte mujore ndikon që menaxhmenti i ATK-së të mos ketë një pasqyrë të qartë të obligimeve. Kjo rritë rrezikun që planet apo objektivat e ardhshme të mos arrihen për shkak të nevojës për t'i paguar obligimet e paraprake.

Rekomandimi 14 Drejtori i Përgjithshëm duhet sigurojë që raportimi i obligimeve të jetë i saktë dhe i plotë dhe se këto raporte japin informata të plota për menaxhmentin dhe palët tjera për obligimet aktuale. Po ashtu në raportimet mujore duhet të përcjelllet kronologjia e faturave të papaguara në mënyrë që faturat e papaguara të raportohen deri sa të paguhen dhe që menaxhmenti dhe Thesari të kenë informacionin e saktë për obligimet e mbetura.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.1 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e rekomandimeve të bëra nga AP për vitin e kaluar.			Nuk janë marrë masa.
2.4 Lista kontrolluese e vetvlersimit	Drejtori i Përgjithshëm duhet të avancoj planin e veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave të organizatës.	Po		
2.5.2 Sistemi i Auditimit të Brendshëm	Drejtori i Përgjithshëm duhet të caktoj një përfaqësues në komitetin e auditimit, në mënyrë që të sigurohet për diskutimin e të gjeturave dhe implementimin e rekomandimeve të ATK-së.	Po		
3.3. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se ka analizuar trendin historik të buxhetit për projekte kapitale dhe ka ndërmarr masa për përmirësim. Po ashtu, për të rritur realizueshmërinë e buxhetit për projekte kapitale ka analizuar mangësitë në procesin e buxhetimit për evitimin e tyre në të ardhmen.	Po		
3.3. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Drejtori i Përgjithshëm duhet të vazhdojë diskutimet me Ministrin e Financave për të siguruar që buxheti për vitet e ardhshme aprovohet në bazë të kërkesave reale të dorëzuara nga ATK me qëllim që financimi i pagave të bëhet në mënyrë transparente.	Po		
3.4 Të hyrat	Drejtori i Përgjithshëm duhet të shtoj masat për identifikimin e shkaktarëve për të dhënat jo konsistente dhe eliminimin e tyre në mënyrë që të sigurohet harmonizimi i të dhënave lidhur me rimbursimet.			Nuk janë marrë masa.

3.4 Të hyrat	Drejtori i Përgjithshëm duhet të shtoj kontrollet për të siguruar që kërkesa e tatimpaguesve të aprovuara për rimbursim të shqyrtohen brenda afatit të përcaktuar kohor.		Janë shkurtuar afatet kohore apo vonesat në aprovimin e kërkesave për kthim.	
3.5 Prokurimi	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se në rastet e përdorimit të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë të bëhet njoftimi në KRPP brenda afateve ligjore.	Po		
3.6 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj që respektohen kërkesat ligjore në lidhje me detyrimet që rrjedhin nga Aktgjykimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës.			Nuk janë marrë masa.
3.6.2 Kompensimi paga dhe medijtje	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj që të gjitha të dhënat në aktet e emërimit azhurnohen me kohë.	Po		
3.7 Pasurit kapitale dhe jo kapitale	Drejtori i Përgjithshëm duhet t'i rishikoj kontrollet ekzistuese në menaxhimin e pasurisë. Kontrollat në këtë fushë duhet të forcohen në mënyrë që pasuritë të ruhen nga humbja keqpërdorimi.		Mos menaxhimi i pasurive financiare jo kapitale nën 1000€ përmes sistemit e-pasuria.	
3.7.3 Trajtimi i te arketueshmeve	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj ndërmarrjen e masave të duhura, përfshirë veprimet ligjore në mënyrë që të shtoj efikasitetin në inkasimin e parasë publike.			Nuk janë marrë masa.

Shtojca IV: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finasije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft-raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Administratës Tatimore të Kosovës, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

pci

z.Sakip Imeri

Drejtor i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës,

Data: 16.06.2017, Prishtinë

